



**BASHKIA TIRANË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr.1, datë 12.02.2015

**PËR  
“VENDOSJEN E BUSTIT TË Z. ALEKS BUDA, HISTORIAN DHE KRYETARI I PARË I  
AKADEMISË SË SHKENCAVE ”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 8/VII gërma “a”, nenit 10 pika 3/I, shkronja “ë” dhe nenit 32, gërma “m” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin për vendosjen e bustit të figurës së mirënjohur të shkencave albanologjike, historianit të Mesjetës dhe Rilindjes Kombëtare, si dhe kryetari i parë i Akademisë së Shkencave, me propozim të Kryetarit të Këshillit Bashkiak.

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë vendosjen e bustit të figurës të shkencave albanologjike, historianit të Mesjetës dhe Rilindjes Kombëtare, si dhe kryetari i parë i Akademisë së Shkencave, Z. Aleks Buda, në lulishten përpara Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Busti do ketë nënshkrimin “Aleks Buda 1910- 1993”

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**ALDRIN DALIPI**